



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



KPM- 2017/01

Në mbështetje të nenit 3, paragrafi 2, pika 6 dhe 11, të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Ligjit Nr. 05/L-027 për Dixhitalizimin e Transmetimeve Radiodifuzive Tokësore, KPM miraton këtë:

RREGULLORE PËR OPERATORËT E MULTIPLEKSIT NË NIVEL SHTETËROR

NENI 1 QËLLIMI

Kjo Rregullore përcakton të drejtat dhe obligimet, kushtet dhe termet e përgjithshme si dhe kriteret që kërkohen të zbatohen operatorët e multipleksit të licencuar nga KPM-ja, përfshirë ofrimin e kapaciteteve të mjaftueshme për ofruesit e shërbimeve mediale.

NENI 2 FUSHËVEPRIMI

Kjo Rregullore do të zbatohet për operatorin e multipleksit të Transmetuesit Publik dhe për dy operatorët e multipleksit në nivel shtetëror në pajtim me Ligjin për Dixhitalizim Nr. 05/L-027.

NENI 3 PËRKUFIZIMET

1. **Operatori i multipleksit** - personi juridik që ofron infrastrukturën teknike për shpërndarjen tokësore të programeve dixhitale dhe shërbimet suplementare për transmetimin dixhital të të dhënave;
2. **Operatori i rrjetit** - është çdo person juridik, i cili ofron çfarëdo forme të rrjetit për transmetim të programeve ose një shërbim transmetimi për publikun dhe posedon licencën korresponduese, ose autorizim të lëshuar nga KPM-ja;

3. **Multipleksi** – (në tekstin e mëtejshëm “MUX”) një set i standardizuar i sinjaleve dixhitale, i shprehur në Mbit/s (Mega-bit-për-sekondë), që përmban disa programe televizive dhe/ose të radios dhe/ose të dhëna të tjera, të cilat transmetohen dhe emetohen në të njëjtën kohë dhe në mënyrë të thurur;
4. **Multipleks me mbulim shtetëror** – Operatori i MUX-it i licencuar nga KPM, i cili përmes Planit të Frekuencave për Transmetim Tokësor Televizion Dixhital në Republikën e Kosovës mbulon tërë territorin e Republikës së Kosovës;
5. **Shërbimi medial audiovizuel (SHMAV)** - shërbimi i cili është nën përgjegjësinë editoriale të ofruesit të shërbimeve programore dhe parim kryesor i së cilës është ofrimi i programeve, me qëllim që të informojnë, argëtojnë apo të edukojnë gjithë publikun përmes rrjeteve të komunikimeve elektronike;
6. **Shërbimi medial audio (SHMA)** – shërbim i cili është nën përgjegjësinë editoriale të ofruesit të shërbimit medial audio dhe parim kryesor i të cilit është ofrimi i programeve, me qëllim që të informojë, argëtojë apo edukojë gjithë publikun, përmes rrjetave të komunikimeve elektronike. Shërbimi medial audio është ose një radio transmetim, një shërbim medial audio me kërkesë apo komunikim komercial në shërbimet mediale audio;
7. **Ofruesi i shërbimeve mediale (OSHM)** – personi fizik ose juridik që ka përgjegjësi redaktuese për përzgjedhjen e përmbajtjes së programeve audio apo audiovizuale të shërbimit mediatik audiovizual dhe i cili përcakton mënyrën se si ato do të organizohen;
8. **Televizioni Tokësor Dixhital** – sistem televiziv me anë të të cilit programet televizive ju transmetohen përdoruesve me anë të mjeteve radio tokësore përmes multipleksit, në pajtim me standardin dixhital televiziv;
9. **Licencë** - leja e dhënë nga KPM-ja për operatorin e multipleksit për të ushtruar aktivitet transmetimi në Republikën e Kosovës;
10. **I Licencuar** - personi juridik i licencuar nga KPM për të vepruar si operator multipleksi;
11. **DVB-T2** (Digital Video Broadcasting-Terrestrial) – Video Transmetimi Dixhital Tokësor;
12. **H.264 dhe H.265/HEVC** – standardet e kompresimit të të dhënave audio- video;
13. **Rrjet me Një Frekuencë të Njëjtë (Single Frequency Network- SFN)** – Rrjet i transmetuesve të sinkronizuar që përhapë sinjale të njëjta në të njëjtin kanal të transmetimit;
14. **Brezi VHF**– Brezi 174-230 MHz;
15. **Brezi UHF**– Brezi 470-862 MHz;
16. **Plani i frekuencave të transmetimit** – plani i frekuencave të radio transmetimit ose të transmetimit televiziv i caktuar nga autoriteti kompetent për telekomunikim për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe që menaxhohet nga Komisioni i Pavarur i Mediave;

17. **ITU** – Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit;
18. **EPG** – Udhëzuesi Elektronik Programor;
19. **LCN** – Renditja Logjike e Kanaleve;
20. **CAM** (Conditional Access Module) – Modul për Qasje të Kushtëzuar;
21. **Televizioni me kualitet standard (SDTV)** - shërbimi i fotografisë dhe zërit të cilësisë standarde, në pajtim me rekomandimet relevante të Unionit Ndërkombëtar për Telekomunikacion (rekomandimet e ITU-së);
22. **Televizioni me kualitet të lartë (HDTV)** – shërbimi që ofron fotografi dhe zë me cilësi më të lartë sesa cilësia standarde, duke i shtuar numrin e linjave analizuese për fotografi, duke ndryshuar metodën e analizës së fotografisë, duke e rritur proporcionin e faqeve të fotografisë në 16:9, si dhe duke i ndryshuar karakteristikat kolorometrike të fotografisë, në pajtim me rekomandimet;
23. **Set-up-box (STB)** – pajisje e veçantë për pranimin, dekodimin dhe transformimin e sinjalit televiziv dixhital në një formë të përshtatshme për riprodhimin e fotografisë, zërit dhe të dhënave tjera.

NENI 4 **DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

1. I Licencuari është i autorizuar të përdorë frekuencat në përputhje me parametrat teknike dhe zonën e mbulueshmërisë të përcaktuar në Licencë.
2. I Licencuari obligohet të veprojë sipas rregullave të përcaktuara lidhur me përdorimin e spektrit radiodifuziv, në pajtim me Planin e Frekuencave për Transmetim Tokësor Dixhital në Republikën e Kosovës si dhe standardet e ITU-së që përcaktojnë DVB-T2 dhe H.264 ose më të ri (H.265/HEVC).
3. Shtrirja e mbulueshmërisë në nivel shtetëror, nga ana e Operatorit të MUX-it duhet të bëhet sipas sistemit të Rrjetit me Një Frekuencë të Njëjtë (tani e tutje SFN).
4. Kapaciteti i MUX-it gjithashtu mund të përdoret edhe për shërbimet shpesh që kanë të bëjnë me transmetimin: titrat, EPG, transmetimet dixhitale audio dhe teleteksti. Për këto shërbime nuk do të tejkalohet 20% e kapacitetit të përgjithshëm të MUX-it.
5. Ndarja e kapacitetit të multipleksit lidhur me përfshirjen e kanaleve jo vendore, në transmetim të hapur apo me pagesë, do të përcaktohet me një akt të veçantë nga KPM-ja.
6. Në rast se operatori i MUX-it është në të njëjtën kohë edhe OSHM, do të mbajë llogari të ndara kontabël për veprimtaritë e ndërlidhura me menaxhimin e multipleksit dhe menaxhimin e OSHM-së.

NENI 5 KUSHTET E PËRGJITHSHME

1. I Licencuari duhet në çdo kohë të respektojë dispozitat e konventave ndërkombëtare që rezultojnë nga Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit (ITU) lidhur me transmetimin dixhital tokësor si dhe aktet tjera përkatëse të zbatueshme në Republikën e Kosovës.
2. Para qasjes në kapacitetin e multipleksit të ndarë, programet e OSHM-ve duhet të kodohen nga MUX-i në pajtim me standardin kodues të ITU-T-së H.264 (ose më të ri). Ndërsa, pranuesi i fundit duhet të jetë i përcaktuar me standardin kodues të ITU-T H.265/HEVC që e përkrah edhe standardin H.264.
3. Transmetuesi publik përdorë multipleksin për kanalet e veta dhe eventualisht për kanalet tjera jokomerciale nën kushtet e miratuara nga KPM.
4. Operatori i MUX-it është i obliguar t'u sigurojë të gjithë ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuale kushte të barabarta dhe jo-diskriminuese të qasjes në multipleksin që menaxhohet nga operatori i MUX-it, në kuptim të së drejtës për të shpërndarë programe, duke shfrytëzuar teknologji transmetuese radio difuzive dixhitale.
5. I Licencuari obligohet që të shfrytëzojë kapacitetin dixhital sipas kushteve të përcaktuara nga KPM-ja.
6. I Licencuari nuk mund të ndryshojë kapacitetin e përcaktuar nga KPM për shpërndarje të programeve që shfrytëzojnë teknologji për televizion me rezolucion të lartë (HD) pa miratim të KPM-së. Kapaciteti i rezervuar për teknologji për televizion me rezolucion të lartë (HD) do të vihet në dispozicion në kushte të barabarta dhe jodiskriminuese për transmetimin dhe shpërndarjen e programeve të të gjithë OSHM-ve.
7. I Licencuari obligohet të ofrojë shërbime të transmetimit dixhital të kualitetit teknik në pajtim me standardet teknike të përcaktuara me Pakon e Licencës së KPM-së.
8. I Licencuari obligohet të sigurojë mbulueshmëri në nivel shtetëror.
9. I Licencuari obligohet të zbatojë Rregulloren për Renditje Logjike të Kanaleve.

NENI 6 MARRËDHËNIA E OPERATORIT TË MULTIPLEKSIT DHE OPERATORIT TË RRJETIT

1. Operatori i multipleksit, në bazë të nenit 7, paragrafi 2 i Ligjit Nr. 05/L-027 për Dixhitalizimin e Transmetimeve Radiodifuzive Tokësore, mund të jetë edhe operator i rrjetit për transmetim digjital tokësor.
2. Operatori i multipleksit në nivel shtetëror që është edhe operator i rrjetit për transmetim digjital tokësor do të ndërtojë rrjetin në pajtim me kriteret e përcaktuara nga KPM sa i përket realizimit të mbulueshmërisë dhe aspekteve tjera teknike.

3. Në rastet kur operatori i multipleksit nuk është edhe operator i rrjetit për transmetim tokësor digjital, operatori i multipleksit do të shfrytëzojë shërbimet e transmetimit të një operatori të rrjetit të licencuar nga KPM.
4. Operatori i multipleksit që është edhe operator i rrjetit, do të mbajë llogari të ndara kontabël për veprimtaritë e ndërlidhura me menaxhimin e multipleksit dhe menaxhimin e rrjetit.

NENI 7

KUSHTET TEKNIKE

1. Operatori i MUX-it do të përdorë standardin DVB-T2, H.264 ose më të ri (H.265/HEVC) me kapacitet prej së paku 37 Mbit/s.
2. Operatori i MUX-it duhet të sigurohet që ofrimi i sinjalit për shfrytëzuesit e fundit bëhet duke përkrahur këto standarde minimale:
 - 2.1 kompatibilitet për pranim të sinjalit DVB-T2 H.265/HEVC, që përkrah edhe standardin H.264.
 - 2.2. pranimin e brezit frekuencor VHF 174-230 MHz dhe UHF 474-862 MHz;
 - 2.3. demodulimin COFDM QPSK/16QAM/64QAM/256QAM;
 - 2.4. përkrahje të RLK (renditjes logjike të kanaleve);
 - 2.5. përkrahje të CAM (modulit për qasje të kushtëzuar);
 - 2.6. përkrahje të EPG;
 - 2.7. përkrahje të teletekstit, titrimit, shumëllojshmërisë së gjuhës; dhe
 - 2.8. përkrahje të video standardeve SD dhe HD.

NENI 8

UDHËZUESI ELEKTRONIK I PROGRAMIT (EPG)

1. Operatori i MUX-it duhet të ofrojë për përdoruesit mundësinë e qasjes në shërbimet e EPG. Këto shërbime u mundësojnë përdoruesve që me anë të telekomandës televizive të kërkojnë në menytë e informacioneve sipas orareve duke përzgjedhur dhe duke u informuar për kohën, titujt, kanalet apo zhanret e programeve.
2. Operatori i MUX-it duhet vazhdimisht të përditësojë udhëzuesin elektronik programor me të dhënat që do të sigurohen nga OSHM-të, në mënyrë që përdoruesit të kenë qasje në informata.

NENI 9

OBLIGIMET E OPERATORËVE TË MUX-IT NDAJ OSHM-ve

1. I Licencuari obligohet që të sigurojë kushte të drejta, të barabarta dhe jo-diskriminuese për qasje në MUX, për të gjithë ofruesit e shërbimeve mediale audiovizuale të licencuara nga KPM.
2. I Licencuari obligohet që të përfshijë në MUX vetëm OSHM-të të licencuara nga KPM-ja për transmetim në MUX.
3. Përcaktimi i çmimit për përfshirje në MUX do të bëhet në bazë të kalkulimit të kapacitetit të shërbimit të hapësirës (Mbit/s).
4. Për çdo ndryshim të shërbimeve ndaj OSHM-ve i Licencuari obligohet të marrë miratim paraprak nga KPM-ja.
5. I Licencuari obligohet të përfshijë në MUX të gjithë OSHM-të e licencuara nga KPM për transmetim analog për bartje të detyrueshme sipas nenit 18 të Ligjit për Dixhitalizim si dhe aktit përkatës nënligjor të KPM-së.

NENI 10

ZBATUESHMËRIA PËR PRONËSINË E HUAJ

Pronësia e huaj e një operatori të MUX-it lejohet vetëm në rastin e kompanive komerciale të regjistruara ligjërisht në Republikën e Kosovës në përputhje me ligjet e aplikueshme.

NENI 11

KOHËZGJATJA DHE RIPËRTËRITJA E LICENCËS

Në pajtim me nenin 21, paragrafi 1 pika 2.1 të Ligjit të KPM-së, kohëzgjatja dhe ripërtëritja e licencës për operator të MUX-t do të jetë 10 vite.

NENI 12

BARTJA E LICENCËS

1. Kërkesa për ndryshimin e pronësisë së Licencës së KPM-së do shqyrtohet në pajtim me procedurat e përcaktuara nga KPM.
2. Licenca e KPM-së mund të bartet tek një palë tjetër vetëm me miratimin paraprak me shkrim nga KPM-ja.

NENI 13

TARIFAT VJETORE TË LICENCËS

I Licencuari obligohet të paguajë tarifën vjetore për licencë të multipleksit të përcaktuar me akt të veçantë të KPM-së.

NENI 14 RAPORTIMI


I Licencuari është i obliguar t'i paraqes KPM-së raportin vjetor përkitazi me veprimtarinë e tij sipas kërkesave të KPM-së.

NENI 15 SANKSIONET

Për shkelje të kësaj Rregulloreje KPM do të ndërmarrë masat ligjore në pajtim me Ligjin për Dixhitalizim Nr. 05/L-027 dhe Ligjin e KPM-së Nr. 04/L-44.

NENI 16 HYRJA NË FUQI

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Adnan MEROVCI
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave



25.01.2017

Data